



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
**Kuvendi i Komunës Rahovec**  
*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*



**PROCESVERBAL**

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), e mbajtur më **18.04.2024**, me fillim në ora **10:10**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **z. Arbër Zenuni**.

**Kryesuesi:** Fillimisht, përshëndetje për të gjithë! Përshëndetje Nënkyetar, **z. Fatmir Iska**. Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorë të drejtorive, zyrtarë komunalë, përfaqësues të KFOR-it, të gjithë ju të pranishëm. Faleminderit shumë për pjesëmarrjen. E hapim mbledhjen e **katërt (4)** të Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2024. Në konsultim me kryetarin e komunës kemi përgatitur këtë rend dite;

**REND DITE**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i vendimit për përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Arsim në Komunën e Rahovecit;
3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për miratimin e vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës personave fizikë dhe juridikë, P- 71510057-01643-1, zk - Rahovec;
4. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P- 71510057-01643-1, zk - Rahovec;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës – hapësirën e objektit të QKMF-së për shfrytëzim Ministrisë së Shëndetësisë;
6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për themelimin e Muzeut të Masakrës së Krushës së Madhe;
7. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P- 01469-1, zk – Rahovec;
8. Shqyrtimi i propozim-vendimit për miratimin e vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës personave fizikë dhe juridikë, P- 71510069-01505-0, zk - Retijë;
9. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës
10. Shqyrtimi i propozim-vendimit për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës së institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese parauniversitare (IEAAP);
11. Të ndryshme.

**Kryesuesi:** Atëherë, sa i përket rendit të ditës a kemi ndonjë propozim tjetër nga anëtarët e KPF-së?... Nëse jo, atëherë e vendosim në votim. Unanimisht votohet rendi i ditës.

**1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

**Kryesuesi:** Atëherë, a ka dikush diçka rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar?... Nëse jo, atëherë e vendosim në votim. Kush është “për”?... Unanimisht aprovohet procesverbali i mbledhjes së kalur.

## **2. Shqyrtimi i vendimit për përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Arsim në Komunën e Rahovecit;**

**Nënkryetari:** Faleminderit! I nderuar kryesues, të nderuar anëtarë të KPF-së. Para vetes e keni vendimin për përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Arsim. Në këtë rast kemi të bëjmë vetëm me një zëvendësim, kшту që në kuvend anëtarët e votojnë për këtë ndryshim, sepse i njëjti është edhe anëtarë i KPF-së.

**Kryesuesi:** Faleminderit nënkryetar! A kemi ndonjë diskutim? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim! Kusht është “për”?... Kundër?... Unanimisht votohet edhe pika e dytë e rendit të ditës.

## **3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për miratimin e vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës personave fizikë dhe juridikë, P- 71510057-01643-1, zk - Rahovec;**

**Afrim Oruqi:** Faleminderit kryesues! I nderuar nënkryetar, kolegë, anëtarë të KPF-së. Me propozim të kryetarit të komunës, bazuar në ligjet e aplikueshme ju propozojmë që të marrim vendim për ta dhënë një pjesë të sipërfaqes prej parcelës së përgjithshme 70 ari e 64m<sup>2</sup>. Prej pjesës së përgjithshme t'i ndajmë 73m<sup>2</sup> dhe në procedura të tjera t'ia japim me qera njerëzve të interesuar përmes ankandeve publike. Bëhet fjalë për parcelën 1643-1 prej sipërfaqes së përgjithshme të përmendur më lartë, po i shkëpuem 73m<sup>2</sup>.

**Defrim Kafexhiu:** Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Një pyetje për drejtorin: Specifikisht të na tregoni se për cilën parcelën bëhet fjalë!

**Afrim Oruqi:** Materiali e ka të bashkëngjitur një skicë të terrenit, që në kuvend do ta prezentoj me skicë dhe me ortofoto. Bëhet fjalë saktësisht të shtëpia e shëndetit – emergjenca. Është shumë e madhe. Aty ka pasur konteste pronësore dhe gjithashtu ka shumë prona private. Saktësisht bëhet fjalë në rrugën e semaforëve të dytë, aty është një autolarje dhe është rruga me kubëza që na qon në drejtim të ETC-së.

**Defrim Kafexhiu:** Atëherë po e them unë saktësisht! Më duket që kjo parcelë, të cilën e propozon kryetari i komunës – kuvendi të jepet në shfrytëzim për 15 vjet, është saktësisht parcela që aktualisht po shfrytëzohet prej një stomatologu, që rishtazi është anëtarësuar në Aleancë.

**Afrim Oruqi:** Kuvendari e ka kuptuar shumë drejt. Bëhet fjalë saktësisht për të njëjtën parcelë, për të cilën komuna e Rahovecit me këtë stomatolog ka kontratë një vjeçare për shfrytëzim. Për informatën e dytë që është anëtarësuar në Aleancë, nuk e kam këtë informatë, po mund ta pyesim sekretarinë e partisë që të sigurohemi. Nëse është anëtarësuar, paska bë mirë, i ftoj edhe të tjerët që të bashkëngjiten.

**Burim Krasniqi:** Faleminderit kryesues! Drejtor, ajo është uzurpim! Është ndërtuar një podrum, janë ndalur punimet prej inspektoratit të komunës, ka mbetur pezull gati për dy vite dhe është fakt që kur ka kaluar në Aleancë është lejuar që ajo parcelë të bëhet me kubëza dhe të shfrytëzohet për parking. Si anëtar i KPF-së nuk jam i mendimit që kjo pikë e rendit të ditës të shkojë në asamble komunale. Vazhdoni me kontratën një vjeçare, nuk jemi të gatshëm të votojmë diçka që ka ndodhur dje. Kërkoj nga kryesuesi që nëse në asamble komunale vjen për votim, le të jetë një material si informatë nga Drejtoria e Inspektoratit rreth procedurave që janë zhvilluar për atë parcelë. Kur ka shkuar inspektorati për herë të parë? Çfarë veprime ka marrur? Deri ku ka shkuar procedura dhe në çfarë forme është dhënë në shfrytëzim? Ne jemi në Rahovec dhe secili - secilin e njohim. Kërkohet të legalizohet një uzurpim që ka ndodhur dhe të cilin inspektorati nuk e ka vazhduar deri në fund. Unë nuk jam i mendimit që kjo duhet të shkojë në asamble komunale, në këtë format.

**Shqipe Kryeziu:** Faleminderit kryesues! Drejtor, faleminderit për sqarimin. Unë mendoj që duhet ta vendosim në votim, le të kalojë në kuvend, vota është e lirë.

**Afrim Oruqi:** Një informatë për hir të kuvendarit Burim Krasniqi. Këtu kur ka filluar ndërtimi i atij objekti, objekti është me leje, ka pasur tentim që të preket parcela komunale. Inspektorati ka dalur në terren për ta kryer punën që i takon, ka bërë procesverbal dhe i ka ndalur punimet. Më pas, e ka njoftuar Drejtorinë e Gjeodezisë. Ne kemi dalur në terren dhe kemi konstatuar që është prekur prona komunale, kemi nxjerrë vendim dhe kemi ndërprerë punimet. Është

tërhequr pronari. Objekti ka leje, ka bërë kërkesë në Drejtori të Shërbimeve Publike. Vendim për uzurpim nuk ka. Pronari e ka marrë në shfrytëzim deri në 12 muaj, duke e paguar taksën që i takon muaj për muaj. Qëllimi ynë dhe i inspektoratit është që të identifikojmë hapësira publike që janë në interes të qytetarëve dhe të bizneseve në Komunën e Rahovecit, që t'ju japim në shfrytëzim atyre sipas ligjit dhe t'i inkasojmë disa "centa" në buxhet të Komunës së Rahovecit. Në seancën e kuvendit për informatën e juaj do t'ju sjelli: njoftimet për procesverbalet e inspektoratit, njoftime të inspektoratit karshi Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi, vendimet për uzurpim, vendimet për shfuqizim të uzurpimit, sepse është liruar hapësira hapësira publike, kërkesën për ta marrur në shfrytëzim, kontratën që e posedon në shfrytëzim dhe pagesën. Për këtë informatë që nuk iu kam ofruar më herët është gabimi im. Ju ftoj ta votoni tutje, sepse është në interes të qytetarëve dhe në interes të buxhetit të Komunës së Rahovecit.

**Defrim Kafexhiu:** E kam edhe një pyetje për drejtorin ose për ekzekutivin: Në atë pjesë (padina), shumica e parcelave private dhe shumica e shtëpive të banimit janë në pronë komunale. Pse nuk po krijohen në përgjithësi lehtësira për të gjithë, ose falja e këtyre pronave, apo edhe lokalet afariste që janë në pronë publike t'ju jepni në shfrytëzim familjeve që aktualisht i shfrytëzojnë. Unë po e them troç, Burimi nuk e tha, që dikush që u anëtarësua rishtazi në Aleancë po përfiton duke marrë në shfrytëzim legal dhe kojshitë e tij po privohen prej kësaj mundësie. Pse të paktën nuk po e rregulloni këtë çështje në atë lagje, për të gjithë njëjtë?

**Burim Krasniqi:** Fatbardhësisht apo fatkeqësisht kam punuar edhe inspektor në Komunën e Rahovecit pak kohë. E njoh edhe punën e Inspektoratit. E para, nuk besoj që është parimore dhe ligjore që uzurpatori të trajtohet si jouzurpator. Ai veprim që ka ndodh nuk është kthyer kurrë në gjendjen paraprake, para se t'i jepet në shfrytëzim. E di edhe cila kompani e ka punuar atë punë. E dyta, nuk e mendojmë të drejtën e përfitimit të komunës. Komuna nuk po humb asgjë në këtë drejtim, ai e ka në shfrytëzim me kontratë një vjeçare dhe po ia paguan tarifën komunës. Në parim, nuk ka asgjë të keqe që ai ta vazhdojë kontratën çdo herë për një vit, sepse të hyrat janë dhe komuna nuk po dëmtohet financiarisht nëse nuk e votojmë në asamble komunale. Nuk mendoj që është arsyeshme ta dërgojmë tutje dhe përkrahjen time si anëtar i KPF-së dhe si përfaqësues i LDK-së nuk e ka në këtë proces të votimit.

**Afrim Oruqi:** Në pyetjen e kuvendarit Kafexhiu: Çdo biznes, për hapësirën para lokalit për çdo vit e bën kërkesë në shërbime publike dhe secili e paguan për shfrytëzim. Çdo shtëpi në Komunën e Rahovecit, gjithashtu edhe shtëpitë në atë lagje që e kanë prekë pronën komunale kanë aplikuar në urbanizëm për legalizim. Të gjitha këto kanë kaluar në listë të pritjes. Qeveria e Kosovës me organet kompetente do të vendosë se çka të bëhet me atë pjesë. Ai që kërkon ta shfrytëzojë trotuarin, ka kontratë me shërbimet publike, e paguan dhe e shfrytëzon. Në pyetjen e kuvendarit Burim Krasniqi: E kam për obligim moral dhe ligjor, nuk prezantoj pika këtu që të mendojmë që personi fizik apo juridik është uzurpator, nuk është uzurpator, nuk ka vendim për uzurpim. 2-3 herë e cilësove si uzurpator, nuk e njoh, nuk e di, nuk është uzurpator me letra. Si do ta propozoj një sipërfaqe, në qoftëse një person fizik që po aludoni ju është uzurpator i filan parcelës. Kur ka filluar ndërtimi aty, ne e kemi obliguar me vendim që brenda 15 ditëve të kthehet në gjendjen e mëparshme. Ti vet i ke pa shiritat aty, e ka mbushur me shavorr dhe e ka kthyer siç ka qenë. Ndërkohë e ka bërë kërkesën dhe e ka marrë në shfrytëzim për një vit. Ju propozoj që ta dërgojmë në kuvend që t'ja japim në shfrytëzim për 15 vjet.

**Burim Krasniqi:** Si Drejtor të Gjeodezisë dhe si jurist, kur një qytetar e hap një bodrum dhe ndërton themele të bodrumit, në kuptimin juridik si cilësohet? Kur bën ndërhyrje në pronën komunale, si cilësohet? Sepse më thua që unë po e cilësoj ashtu, e nuk është uzurpator sepse nuk ka vendim. Është shkelje ligjore ose mosveprim i organeve të komunës nëse aty nuk janë marrë veprimet ligjore që e quajnë uzurpim, e në anën tjetër uzurpim quhet një tezgë në Xërxë që shet pemë e perime dhe që mund ta lëvizni kur të doni. Mos më thuaj që unë po e quaj ashtu, por e quan ligji dhe mosveprimi i organeve kompetente të komunës është përgjegjësi e juaja (ekzekutivit).

**Afrim Oruqi:** Në kohën kur ka ndodhur ky veprim, të gjitha organet kanë dalur dhe kanë vepruar, nuk është fjala për mosveprim. Në atë kohë ka pasur pretendim që ka prekje të pronës publike, ka pasur vendim për uzurpim, sepse

nuk kemi lënë pikë e presje pa e vendosur në vend në momentin kur është prekur prona publike. Në prill të vitit 2024, prona është e lirë, me kontratë sipas ligjeve të aplikueshme dhe nuk është uzurpim.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! Atëherë, nëse nuk kemi diskutime të tjera, e vendosim në votim! Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë, me 4 vota pro dhe 3 vota abstenim, kalon kjo pikë e rendit të ditës.

**4. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, P- 71510057-01643-1, zk - Rahovec;**

**Afrim Oruqi:** Për shkak se pika më herët na konsumojë shumë kohë, ju ftoj që të votojmë formimin e komisionit që do të merret me të gjitha procedurat për parcelën dhe sipërfaqen e njëjtë.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! Atëherë, nëse nuk kemi diskutime, e vendosim në votim! Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 5 vota pro dhe 1 abstenim, kalon edhe kjo pikë e rendit të ditës.

**5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës – hapësirën e objektit të QKMF-së për shfrytëzim Ministrisë së Shëndetësisë;**

**Nënkryetari:** Në mungesë të drejtoreshës e cila nuk gjendet në Kosovë, po e prezantoj propozim – vendimin për dhënien në shfrytëzim të pronës – një pjesë të hapësirës së QKMF-së. Në propozim – vendim e keni të specifikuar edhe afatin e dhënies në shfrytëzim dhe të tjerat (15 vjet). Përpos angazhimit të madh të kryetarit për funksionalizimin e kësaj qendre, nga këtu e falënderoj edhe zv. Ministrin e Shëndetësisë Dr. Arsim Berisha për kontributin e dhënë që ky repart i hemodializës të funksionalizohet me kohë në komunën tonë.

**Kryesuesi:** Faleminderit nënkryetar! Atëherë, nëse nuk kemi diskutime, e vendosim në votim! Kush është “për”?... Unanimisht votohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

**6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për themelimin e Muzeut të Masakrës në Krushës të Madhe;**

**Afrim Dina:** Faleminderit kryesues! I nderuar nënkryetar, kolegë drejtorë, anëtarë të KPF-së. Para vetes keni propozim – vendimin e kryetarit të komunës për themelimin e Muzeut të Masakrës në Krushë të Madhe. Qëllimi i themelimit të muzeut është mbledhja, sistemimi dhe ruajtja e artefakteve dhe dokumenteve të të vrarëve nga forcat serbe gjatë luftës 1999, konkretisht me datat 25, 26, 27 mars. Objekti është përruar këtë vit, 26 mars dhe përbrenda projektit janë artefaktet, dokumentet dhe video të ndryshme, që vizitorët kanë mundësi të informohen më shumë rreth luftës 1999 në Krushë të Madhe. Janë procedura që kërkojnë aprovimin e kuvendit të komunës, që të vazhohet tutje me procedura të tjera.

**Burim Krasniqi:** Drejtor, pa dashur ta diskutoj botëkuptimin a bëhet a nuk bëhet kjo, sepse nuk ka logjikë të diskutohet. Te pika dy thotë: Për dhunën nga forcat serbe në Krush të Madhe! A është fokusi vetëm në Krushë të Madhe, apo përfshihet edhe jashtë Krushës (në Komunën e Rahovecit në përgjithësi)?

**Afrim Dina:** Aktualisht është muzeu i parë që pas 25 viteve po bëhet dhe ka të bëjë vetëm me pjesën e masakrës në Krushë të Madhe.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! Atëherë, nëse nuk kemi diskutime, e vendosim në votim! Kush është “për”?... Unanimisht votohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

**7. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-01469-1, zk – Rahovec;**

**Afrim Oruqi:** Të nderuar anëtarë të KPF-së, para jush e keni propozimin për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-01469-1, zk – Rahovec me pronar Shpata Hilmi Hajrullaga, në vendin e quajtur Padinë. Kjo parcelë i ka gjithsej 2 ari e 20m<sup>2</sup> dhe për interes të përgjithshëm janë 185m<sup>2</sup> dhe e ftoj sekretariatën për përmirësim dhe njëkohësisht kërkoj nga ju që ta shpallni interes të përgjithshëm komplet parcelën (2 ari e 20m<sup>2</sup>). Qëllimi i shpalljes në interes të përgjithshëm të kësaj sipërfaqe është që rruga pa dalje të bëhet kadastrale, të ketë zgjerim dhe kubëzim dhe të qasshme për komunitetin që jeton aty.

**Burim Krasniqi:** Drejtor, këtë parcelë kur po e shoh në gjeoportal, del të jetë edhe një pjesë e një objekti të ndërtuar, cili është problemi? Apo është gabim teknik?

**Afrim Oruqi:** Nëse klikojmë në gjeoportal këtë numër të kësaj parcele, parcela është e lirë dhe nuk ka objekt apo ndërtim. Ka mundësi që përreth kësaj parcele ka objekte.

**Defrim Kafexhiu:** Drejtor, për këtë shpallje me interes të përgjithshëm të kësaj parcele, a ka kërkuar kompenzim dhe a e kemi për seancën tjetër kompenzimin për këtë shpallje me interes të përgjithshëm?

**Afrim Oruqi:** Për momentin kompenzim nuk ka kërkuar. Ka një dakordim të palëve, të komunës dhe të pronarit. Ka kërkesë prej banorëve që e frekuentojnë këtë rrugë. Sa i përket kompenzimit, ministria e ka centralizuar punën, ata e vlerësojnë, ne dokumentacionin e dërgojmë në ministrinë kompetente.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! Atëherë, nëse nuk kemi diskutime, e vendosim në votim! Kush është “për”?... Unanimisht votohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

**8. Shqyrtimi i propozim-vendimit për miratimin e vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës personave fizikë dhe juridikë, P- 71510069-01505-0, zk - Retijë;**

**Afrim Oruqi:** Para jush kryetari propozon që ta japim në shfrytëzim pronën e komunës në Retijë. Terreni është fushor - malor në kufij me Mamushën, me sipërfaqe 27 ha 96 ari e 8m<sup>2</sup>. Ne kërkojmë prej juve që të marrim vendim dhe ta japim në shfrytëzim për 40 vjet. Çmimi, ankandi dhe procedurat janë të parapara me rregullore.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! Atëherë, nëse nuk kemi diskutime, e vendosim në votim! Kush është “për”?... Unanimisht votohet edhe pika e tetë e rendit të ditës.

**9. Shqyrtimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës**

**Afrim Oruqi:** Ju propozoj ta formoni komisionin për t'i zbatuar procedurat për vlerësimin e ofertave për të njëjtën parcelë, me sipërfaqe të njëjtë në Retijë.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! Atëherë, nëse nuk kemi diskutime, e vendosim në votim! Kush është “për”?... Unanimisht votohet edhe pika e nëntë e rendit të ditës.

**10. Shqyrtimi i propozim-vendimit për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorit/eshës dhe zëvendës drejtorit/eshës së institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese parauniversitare (IEAAP);**

**Avni Morina:** Faleminderit! Përshëndetje kryesues, anëtarë të KPF-së. Bazuar në udhëzimin administrativ nr. 151/2020, udhëzimin administrativ për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zv. drejtorit të institucionit publik edukativo – arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, për procedurat e zgjedhjes emërimit, të përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, Drejtoria Komunale për Arsim ka bërë këtë propozim për dy anëtarë të komisionit dhe anëtarin e tretë emërohet nga MASHT-i.

**Burim Krasniqi:** Drejtor, unë nuk jam njohës i fushës, por në bazë të diskutimeve që kam pasur me njerëz që e njohin këtë fushë, anëtarë të komisionit duhet të jenë vetëm zyrtarët e DKA-së. E di që më herët ka qenë Vjollca Vuçitërna, drejtoreshë e shkollës profesionale. A e lejon ligji një drejtoreshë të shkollës të jetë anëtare e komisionit, apo kërkohet të jetë një zyrtar i DKA-së? Unë kam informacion që nuk duhet të jetë askush, pos zyrtarëve të DKA-së.

**Avni Morina:** I nderuar, në bazë të udhëzimit administrativ për procedurat e përzgjedhjes së drejtorëve, dy anëtarë caktohet nga DKA. Njëri duhet të jetë zyrtar i DKA-së, tjetri nga institucionet publike në kuadër të DKA-së, në këtë rast drejtorët kanë të drejtë të jenë.

**Kryesuesi:** Faleminderit drejtor! Atëherë, nëse nuk kemi diskutime tjera, e vendosim në votim këtë pikë! Kush është “për”?... Kundër?... Me shumicë votash votohet edhe pika e dhjetë e rendit të ditës.

**11. Të ndryshme;**



**Burim Krasniqi:** Pas diskutimet që i kemi pasur me grupin e asambleistëve, kemi ardhur me dy kërkesa në drejtim të ekzekutivit. Në qoftëse është e mundur t'i kemi dy informatat për seancën e asamblesë komunale. Nëse ka mundësi që Drejtoria e Urbanizmit të na jep informatë mbi numrin e lejeve të ndërtimit në dy vitet e fundit, që iu ka dhënë institucioneve publike dhe private. E dyta: Informatë rreth kanaleve të kullimit të tokave bujqësore dhe kanaleve të tjera. Sipas projekteve deri ku ka arritur realizimi i punëve?

**Defrim Kafexhiu:** E kam një pyetje për drejtorin e Gjeodezisë: Para disa seancave në mbledhje të rregullt të kuvendit e kemi shpallë një parcel me interes të përgjithshëm në lagjen "Vëllezërit Frashëri" për çështjen e trafos të energjisë elektrike. Ku janë procedurat dhe ku ka mbetur puna me atë parcelë prej 12m<sup>2</sup>?

**Kryesuesi:** Faleminderit! Të nderuar anëtarë, ju njoftoj që për mbledhjen e rregullt do të jenë edhe dy pika të tjera: **Raporti financiar janar – mars 2024 dhe Informatë mbi implementimin e projektit të mirëmbajtjes dimërore dhe verore të rrugëve në Komunën e Rahovecit.**

**Defrim Kafexhiu:** Nëse mund ta jap një mendim për këtë çështjen e pikave shtesë. Është më e arsyeshme t'i bëni propozimet këtu, që mos ta bëjmë standard për çdo seancën të kemi pika shtesë. Besoj që nuk është problem që KPF-ja t'i vendosë në rendi dite.

**Nënkryetari:** Unë kam qenë asambleist dhe zakonisht për pikat që kanë qenë pa material, i kemi dhënë kritika ekzekutivit. Singërisht kur ju diskutoni në këtë drejtim, unë jam me ju çdo herë. Si rekomandim prej KPF-së është në rregull.

**Skender Hamza:** Kryesuesi tha që si pika shtesë do të jenë ato dy pika. Prej këtij viti, ekzekutivi në bashkëpunim me sekretarinë ka vendosur që informatat dhe raportet të shkojnë drejtpërdrejt në kuvend. Kryesuesi në këtë rast ju informon që edhe këto dy pika do të jenë në kuvend. Informatat nuk ndryshohet dhe nuk votohet.

**Burim Krasniqi:** Skendë, meqenëse keni përvojë në sekretari të kuvendit. Pikat e rendit të ditës që janë të gatshme për seancë, a janë të obliguar të vijnë në KPF? Për këtë procedurë duhet të vendosë asambleja, ekzekutivi propozon dhe nuk besoj që është e udhës dhe ligjore të thoni që nuk e do ta bëjmë në KPF, por direkt në asamble. Në asamble mund të vie nëse ka diçka ndërkohë që nuk ka mundur të jetë gati për KPF. KPF-ja e bën filtrin e rendit të ditës. Nëse të lexova gabim, të kërkoj falje.

**Defrim Kafexhiu:** Po e korrigjoj pak Skendën! Në bazë të procesverbalit të datës 18 mars të mbledhjes së kaluar, thotë: Pas mbledhjes, kryesuesi njoftoi anëtarët që në mbledhje e rregullt të kuvendit, të muajit mars, janë këto pika shtesë: Vendimi për subvencionimin e mbulimit të shpenzimeve të varimit, vendimi për dhënien në shfrytëzim, vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e stadiumit të qytetit. Kjo d.m.th që jo vetëm informatat kanë ardhur në këtë formë. Burimi, në mbledhjen e muajit të kaluar ka propozuar që të përfshihen pikat në KPF, pavarësisht edhe nëse materiali nuk është gati prej ekzekutivit.

**Skender Hamza:** Defrim, tani unë po të korrigjoj pak! Vendimet janë pika shtesë. Nuk e di a më kuptove, unë fola për informatat dhe raportet, jo për pika tjera. Informatat dhe raportet nuk votohen dhe nuk ndryshohen. Kjo ka qenë arsyeja që t'ia lehtësojmë punën Komitetit për Politikë dhe Financa.

**Nënkryetari:** Po ju korrigjoj të gjithëve! Ideja e informatave është që në shumicën e kuvendeve komunale diskutohet vetëm në kuvend dhe jo në KPF. Sa i përket informatave, secilën prej tyre do ta keni në kuvend dhe jo në KPF. Është një praktikë që po zbatohet në kuvendet e komunave të Republikës së Kosovës.

**Kryesuesi:** Faleminderit nënkryetar! Nëse nuk kemi diçka tjetër, duke iu falënderuar për vëmendjen tuaj, shihemi në mbledhjen e radhës.

Procesmbajtësi;

Albion Krasniqi

